



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 33 prot.

Kamëz, më 23.4.2025

V E N D I M
Nr. 29. Datë 23/4 2025
MBI

MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI STREHIMIT SOCIAL "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË", PËR VITIN 2025.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.04.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.24 Datë 17.04.2025 në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 15 dhe nenit 47, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.06.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", vendimit nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti", VKB nr.155 datë 20.11.2024 "Për miratimin e procedurave lidhur me programin social Subvencioni Interesave të Kredisë"; Relacionit Komisionit Strehimit me nr.2899 Prot datë 28.03.2025, Proçesverbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot nr.2899/1 Prot datë 28.03.2025, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së 46 familjeve për të përfutur nga programi Strehimit Social "Subvencionimi i interesave të kredisë", për vitin 2025, sipas Aneksit nr. 1, dhe relacionit shpjegues bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Familjet e përcaktuara në Aneksin nr. 1 të këtij vendimi, duhet të paraqiten brenda gjashtë muajve pranë institucionit bankar, nga momenti i njoftimit që kryen Bashkia Kamëz. Mosrespektimi i këtij afati është shkak për skualifikimin e tyre.
3. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit për zbatimin e këtij vendimi. Bashkëlidhur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI